



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:163634
Datë: 26.01.2024
Numri i dokumentit: 05247781

C – IV. – 15 - 0698

Paditësi:

T H nga Prishtina, ë, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. H H nga Gllogovci.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.26.01.2024**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET tërësisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, T H nga Prishtina nga Prishtina e parashtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL) dhe Vendimi, PRN126 - 0208 i dt.31.03.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL), **VËRTETOHET, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt.29.04.2015, paditësi, T H nga Prishtina, pranë DhPGJSK-së, përmes të të autorizuarit të tij, Kadri Berisha nga Prishtina, jurist i diplomuar, ka parashtruar padi për pagesën e pagave të mbetura të pa paguara nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe lidhur me Vendimin, PRN029-0209 dt.12.06.2015 të lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për likuidimin e NSh, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë me seli në Prishtinë e me të cilin i është refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e 3 pagave të papaguara nga NSh, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Në arsyetimin e Vendimit të AL-së, ceket se Autoriteti i Likuidimit (AL), pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësjja, ka gjetur se kërkesa e saj është me dëshmi të pa mjaftueshme dhe se për këtë arsye edhe ka kërkuar dëshmi përkatëse, dhe se paditësit, kërkesa nuk ka mundur që t'i dërgohej dhe se për këtë arsye, AKP-ja, përmes njoftimit publik e ka ftuar paditësin që të paraqitet në Zyrat Rajonale të AKP-së në Prishtinë e me qëllim që t'i dorëzohet kërkesa për informta shtesë dhe ky njoftim u publikua me dt.18.05.2015 në gazetata shqip, "Koha Ditore" dhe "Zëri" si dhe gazeta në gjuhën serbe, "Danas dhe "Vijesti" por paditësi, nuk ishte i paraqitur dhe se AL-ja, kërkesë e paditësit, e kishte refuzuar duke u bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L - 034 të AKP-së se ;"*... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*", e më gjerësisht si në këtë vendim të AL-së.

Paditësi në këtë padi/kërkesë, ka theksuar se NSH është regjistruar pranë UNMIK-ut, si SH.A "Auto Prishtina" me dt.24.05.2000,të cilët ishin punësuar 38 punonjës që kishin qenë të punësuar në këtë NSH para marsit 1999. I punësuarit në NSH së bashku me të punësuarit nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishte depozituar një Regjistër me nr.4 dt.12.06.2014, dhe shuma e përgjithshme për të gjithë paditësit, ishte 870,410,00 euro e me propozimin që gjykata të merr aktgjykim e me të cilin, aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, detyrohet e paditura, Agjencioni Kosovar i Privatizimit që paditësit, t'ia paguaj borxhin kryesor për pagat e mbetura të pa paguara për periudhën Tetor 2003 – qershor 2014 në shumën prej 14,690.00 euro, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit, t'ia paguaj kamatën ligjore vjetore në vlerë prej 3,5 % për çdo vit e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi kësaj ankese ia ka bashkangjitur provat kopje: autorizimin për përfaqësim të dhënë nga kryesia e Sindikatës së NSH, "Auto Prishtina" për K B, certifikatën për regjistrimin e biznesit të dt.24.05.2000 për SH.A."Auto Prishtina", konfirmim biznesi të dt.17.04.2000 për SH.A."Auto Prishtina", njoftimin e dt.23.04.2015 së të autorizuarit të paditësit të adresuar në Autoritetin e Likuidimit të Zyrës Rajonale të AKP-së në Prishtinë, shkresën e AKM-së së dt.18.11.2004, shkresën e AKM-së së dt.19.08.2004 (në dy kopje), lista me Nr. protok.4 e dt.12.06.2014 të punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marr rrogat sipas kontratës së punës të lëshuar nga Kryetari i Këshillit të Punëtorëve të NSH,"Auto Prishtina", kontratën e punës, nr. 288 të dt.13.10.2003 të lidhur në mes paditësit dhe SH.A. "Auto Prishtina", deklarata e paditësit të dhënë për Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë dhe kopjen e librezës së punës.

Me dt.02.11.2017, e paditura, AKP, ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit, PRN126 – 0208 të dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) e në të cilën, ka theksuar se ankesa e paditësit, nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë së saj nga neni 72.2 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/ L – 033 sepse paditësi nuk ka bashkangjitur Vendimin e ankimit në ankesë, se mungesa e një autorizimi për përfaqësim nga ana e avokatit përbën shkak të mjaftueshëm për pa pranueshmërinë sipas neni 28 par.2.1 dhe 2.6 së bashku me nenin 25.5 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/ L – 033, se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-033, është shkelur nga AL-ja e kjo përbën shkelje të nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033, se kërkesa e parashtruesit, është parashkruar sepse paditësi, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor kundër NSH-së në periudhën tre vjeçare të parashkrimit e cila fillon të llogaritet më së voni nga shtatori i viti 2003 kur parashtruesi vetë ka pranuar se nuk është paguar nga ana e NSH-së, se parashkrimi bazohet në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L - 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar që sanksionon parashkrimin brenda tre vjetësh, se parashkrimi fillon nga dita e parë që kreditorit i ka lindur e drejta të pretendojë përmbushjen e detyrimit, se pikërisht fakti se kërkesa e paditësit, referon si moment të cenimit

të së drejtës shtatorin e viti 2003, çka përbën sipas nenit 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr.1978/26 dhe ligj i zbatueshëm në kontestin në fjalë) momentin e nisjes së afatit 3 vjeçar të parashkrimit, se AL-ja, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike si dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të zbatueshme, se pa paragjykuar qëndrimin e mësipërm se detyrimi NSh-së (nëse ka ekzistuar ndonjëherë), është shuar përmes parashkrimit, e paditura, thekson se gjithashtu se në fakt detyrimi për të paguar paditësin, nuk ka lindur asnjëherë, se kjo NSh, nuk ka kryer aktivitet ekonomik në periudhën kontestuese, andaj parashtruesi nuk ka punuar për NSh-në gjatë asaj periudhe, se edhe kontrata e punës që paditësi, e ka dorëzuar në shkresat e lëndës, është në mes tij dhe një ndërmarrje private (jo shoqërore), se si pasojë e kësaj NSh-ja nuk ka legjitimitet pasiv në këtë lëndë pasi marrëdhënia juridike për të cilën parashtruesi ankohet këtu është në mes tij dhe një personi të tretë e duke i propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pa pranueshme dhe e pabazuar dhe të vërtetoj Vendimin i Autoritetit të Likuidimit në bazë të nenit 70.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-033 dhe se kësaj Mbrojtjeje, ia ka bashkangjitur kërkesën për emërimin e anëtarëve në Autoritetin e Likuidimit për NSh, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Me dt.20.11.2017, paditësi, ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të paditurës dhe e ka kundërshtuar mbrojtjen e të paditurës, duke përsëritur qëndrimet e paraqitura në padi e me propozimin që t'a refuzoj në tërësi Mbrojtjen e të paditurës dhe i ka propozuar gjykatës që t'a hudh poshtë si të pa bazuar në fakte dhe prova e më gjerësisht si në këtë Përgjigje në mbrojtje

Me dt.10.12.2020, pala paditëse përmes të të autorizuarit të tij, i është drejtuar kësaj gjykate, me parashtrësën lidhur me adresën e saj të të autorizuarit të tij, dhe se kësaj parashtrëse, ia ka bashkangjitur, regjistrin e lëndëve në të cilat janë dorëzuar autorizimet për paditë e ushtruar pranë DhPGJSK-së, të hartuar nga av. Sh B nga Prishtina si dhe kopjen e një autorizimi të dhënë për av. Sh B nga Prishtina.

Me dt.01 Mars 2022, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C - 14 – 15 – 0698 të dt.01.03.2022, ka urdhëruar palën paditëse, që të dorëzoj në këtë gjykate, Vendimin, PRN126 – 0208 të dt.31.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe se pala paditëse, me dt.01.04.2022, ka dorëzuar një kopje të këtij Vendimi.

Me aktgjykimin e saj, C – IV – 15 - 0698 të dt.15 Qershor 2022, gjykata ka refuzuar ankesën e parashtruar të paditësit, e të cilin aktgjykim e ka ankimuar paditësi përmes të autorizuarit të tij dhe se me aktgjykimin, AC-I-21-0390, dt.27 Korrik 2023, Kolegji i Apelit i kësaj gjykate, e ka aprovuar ankesën e paditësit, ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate, C – IV – 15 - 0698 të dt.15 Qershor 2022 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe se në lëndën, C-IV-15-0698, pas kthimit në ri vendosje, janë ndërmarrë veprime plotësuese.

Me dt.31.10.2023, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 0698 të dt.31.10.2023, ka urdhëruar paditësin, T H dhe K B nga Hajvalia, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, të plotësojnë e dt.29.04.2015, në atë mënyrë që t'a çështjen e përfaqësimit ashtu që në këtë gjykatë, të dorëzojnë autorizimin për përfaqësim të lëshuar nga paditësi për K B nga Hajvalia, jurist i diplomuar, dhe i cili duhet t'a provojë para kësaj gjykate, se është avokat dhe është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) e në mënyrë që të ketë të drejtë që paditësin, t'a përfaqësoj në lëndën, C – IV. – 15 – 0698 e me pasojën gjegjëse ligjore në rast të mos veprimit sipas këtij urdhri e më gjerësisht si në këtë urdhër.

Me dt.14.11.2023, av. H H nga Gillogovci, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.14.11.2023, e në të cilën ka sqaruar se revokohet çdo autorizim tjetër për përfaqësim, dhe gjykata duhet t'a ftoj dhe të komunikoj me këtë avokat dhe se kësaj parashtrëse, ia ka bashkangjitur autorizimin e dhënë nga paditësi për këtë avokat për t'a përfaqësuar.

Me dt.29.11.2023, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 0698 të dt.29.11.2023, ka urdhëruar sërish paditësin, T H nga Prishtina, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, t'a precizoj kërkesëpadinë e tij dhe se për cilën kërkesë duhet të vendos kjo gjykatë, se cila është shuma e tri pagave të pa paguara dhe për cilën periudhë kohore, i kërkon këto paga nga NSH''Auto Prishtina'' me seli në Prishtinë (në likuidim), si dhe që të bëjë plotësimin e padisë së tij të paraqitur pranë DhPGJSK-së me dt.29.04.2015 dhe atë kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e që ka të bëjë me Vendimin e AL-së, PRN 126 - 0208 të dt.31 Mars 2015 për shkak të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën prej dt.30.09.2003 e deri në muajin Qershor 2014 dhe në shumën prej 14.690.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore, (NSH) ''Auto Prishtina'' me seli në Prishtinë (në likuidim), në atë mënyrë që kësaj padie, t'ia bashkangjes një egzemplar të Vendimit të AL-së, PRN 126 -0208 të dt.31 Mars 2015, kopjen e Njoftimit të AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës lidhure me këtë Ndërmarrjen Shoqërore, listën e pagave si dhe çdo provë tjetër në mbështetje të padisë së tij e me pasojën gjegjëse ligjore në rast të mos veprimit sipas këtij urdhri e më gjerësisht si në këtë urdhër.

Me dt.12.12.2023, av.H H nga Gllgovci, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtresën e dt.12.12.2023, e me të cilën e ka bërë precizimin subjektiv dhe objektiv të kërkesëpadisë e duke i propozuar gjykatës q ë të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses, F H nga Prishtina, anulohetVendimi i AL-së, PRN126-0208 i dt.31.03.2013 e me të cilën i është refuzuar kërkesa kreditore, e paditëses lidhur ma pagat e pa paguara për periudhën prej dt.30.09.2003 deri me dt.01.06.2014, si kundërligjshëm, dhe obligohet e paditura, AKP – AL i NSH, Auto Prishtina, që kërkesën kreditore të paditëses, t'ia trajtoj si kërkesë të pranuar në vlerën prej 14,690.00 € me kamatë ligjore prej 10 % e duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe të obligohet e paditura, që palës paditëse, t'ia kompensoj shpenzimet procedurale konform tarifë së OAK-ut dhe se kësaj parashtrese, ia ka bashkangjitur provat siç janë: Vendimi i AL-së, PRN126-0208 i dt.31.03.2013, kopjen e dëftesës gjegjëse të paditësit, kopjen e Vendimeve, të DD, ''Auto- Prishtina'', Prishtinë për caktimin e paditësit për kryerjen e detyrave të punës, kopjen e Vendimit, Nr.442 të dt.29.06.1992 të DP, ''Auto- Prishtina'', Prishtinë për pagesën e tejkaluar të punës dhe regjisë, kopjen e Aktvendimit, Nr.02 – 716 të dt.29.12.1991 DP, ''Auto-Prishtina'', Prishtinë për sistemin e paditësit në vendin gjegjës të punës – autorfarbar, kopjen e deklaratës së dt.06.12.1977 së paditësit, kopjen e Vërtetimit mbi përvojën e punës të dt.05.12.2023, kopjen e certifikatës së vdekjes së paditësit, V 10646381 të dt.07.12.2023 e përmes së cilës provohet se paditësi, ka vdekur me 31.07.2022, kopjen e autorizimit të dhënë nga F H nga Prishtina për av.H H nga Gllgovci, kopjen e Ekstraktit nga Libri Amzë i të Martuarve, Nr.07/D3 i dt.3.4.1986 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë dhe kopjen e gjendjes martesore e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë për F H nga Prishtina, bashkëshortja e të ndjerit, T H nga Prishtina.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AK), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS lidhur me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve, pretendimeve të palëve në procedurë dhe duke marrë për bazë vëretjet e bëra në aktvendimin e tij, AC – I – 21 - 0390 të dt.27 Korrik 2023, nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e

paditësit, T H nga Prishtina, e përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, F H nga Prishtina, është e pa bazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e padisë së paditësit.

Gjykata ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me dt.21.07.2014 derisa paditësi në procedurën e likuidimit pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.01.09.2014 brenda afatit ligjor për dorëzimin e kërkesave kurse Autoriteti i Likuidimit (AL) pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit, me Vendimin e tij, PRN126 - 0208 të dt.31.03.2015, e ka refuzuar si të pa vlefshme e duke u bazuar në nenin 36 par.2 nëpar.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së dhe se pas dërgimit të këtij Vendimi, pas dt.31.03.2015, palës paditëse, i njëjti pranë DhPGJSK-së, me dt.24.04.2015, brenda afatit ligjor ka paraqitur padi kundër Vendimit të AL-së, PRN 126- 0209 të dt.12.06.2015, dhe se kësaj padie, ia ka bashkangjitur egzemplarin e Vendimit të AL-së, PRN126 - 0209 të dt.12.06.2015 e jo Vendimin e AL-së, PRN126 - 0209 të dt.12.06.2015, andaj gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni 36 lidhur me nenin 33, 35 dhe nenit 74 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomen e Posaçme lidhur me nenin 37 par.7 e Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në.

Mirëpo pala paditëse, në kohën e bërjes së padisë në dispozitivin e saj, e ka cekur shumë prej 14,690.00 € e me kamatë ligjore prej 3,5 % për çdo vit dhe se kjo shumë rrjedh nga Vendimi tjetër i AL-së, PRN 126 - 0208 të dt.31.03.2015 e që ka të bëjë me pagat e pa paguara për periudhën prej datës 30 shtator 2003 deri në qershor 2014 nga NSH, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim) por se padisë së saj, ia ka bashkangjitur Vendimin e AL-së, PRN 126 - 0209 të dt.12.06.2015 që ka të bëjë me kompensimin e tre pagave të pa paguara nga kjo NSH.

Në nenin 6 të Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se :''*Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ...*'' derisa në nenin 40 par.1 pika 6.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty thuhet se : *Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... 1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim: kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ;*'' derisa kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara në shumë prej 14,690.00 € €, bënë pjesë në kategorinë e kërkesave të pa siguruara nga neni 40 par.1.7 e Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në .

Në nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/2007 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës, që flet për Shkëputjen e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje, është paraparë se : ... *Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. ... (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore; (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore; (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore; (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore; (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore*'' . Po ashtu në nenin 76 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, që flet për Largimet kolektive nga puna, aty parashihet se

:''*Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% e të të punësuarave por jo me pak se njëzet (20) të punësuar, të*

larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga puna; 2. Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen dispozitat nga paragrafi 3. i këtij neni. 3. ... Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle: 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore; 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore; 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore; 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; dhe 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore''.

Për çështjen e pagesës së pagave për të një punësuarin në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”* kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuarin ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”*.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *“Palët, në parashtrësat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës”* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”*.

Në nenin 42 par.2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme , parashihet se : *“Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t’i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Po ashtu sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Mirëpo në bazë të provave të bashkangjitura parashtrësën e dt.12.12.2023, e me të cilën e ka bërë precizimin subjektiv dhe objektiv të kërkesëpadisë, e veçmas kopjes së certifikatës së vdekjes së paditësit, V 10646381 të dt.07.12.2023, e përmes së cilës provohet se paditësi, veçse ka vdekur me dt.31.07.2022.

Përkizati me çështjen e vdekjes së një pale, si në rastin konkret, në nenin 359 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, parashihet se: *“Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit pushon detyrimi vetëm në qoftë se ka lindur duke marrë parasysh*

veçoritë personale të njerës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit “ ndërsa edhe në nenin 340 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për vdekjen e një pale, aty thuhet se : *’Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njerës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit’*. Duke qenë se pala paditëse edhe pse ka paraqitur disa prova para kësaj gjykate vendimarrëse, pas vdekjes së paditësit, T H nga Prishtina, nuk kanë ndikim në vendimarrje tjetër të kësaj gjykate, i autorizuari tani edhe i bashkëshortes së paditësit, edhe pse ia ka bashkëgjitur, provat, siç janë kopja e Ekstraktit nga Libri Amzë i të Martuarve, Nr.07/D3 i dt.3.4.1986 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë dhe kopjen e gjendjes martesore e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë për F H nga Prishtina, dhe me këtë provohet se e njëjta, është bashkëshortja e të ndjerit, T H nga Prishtina, prapë se prapë këto prova nuk kanë ndikim në kërkesën e paraqitur nga paditësi, për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej datës 30 shtator 2003 deri në qershor 2014 nga NSh, "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim) nga Vendimi i AL-së, PRN 126 - 0208 të dt.31.03.2015 si dhe se meqë pala paditëse, ka vdekur, me dt.31.07.2014 në Prishtinë, kërkesat e natyrës së tillë juridike, nuk mund të jenë të bartshme tek trashëgimtarët e paditësit, tani i ndjerë sepse të njëjtat kërkesa lidhen *veçoritë personale të paditësit dhe aftësitë personale të tij*, e në shkresa të lëndës, nuk ka ndonjë vendim të plotëfuqishëm të gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent që para vdekjes, paditësit, t’i jenë njohur këto kërkesa, andaj, gjykata vije në përfundim se, kërkesëpapia e paditësit, T H nga Prishtina, e përfaqësuar nga F H nga Prishtina, bashkëshortja e tij, është e pabazuar.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se pretendimin e të paditurës, AKP-së, se gjetja e AL-së se kërkesa e parashtruar nga paditësi, fillimisht, ka qenë me dëshmi të pa mjaftueshme dhe se për këtë arsye edhe ka kërkuar dëshmi përkatëse, dhe se paditësit, kërkesë nuk ka mundur që t’i dërgohej dhe se për këtë arsye, AKP-ja, përmes njoftimit publik e ka ftuar paditësin që të paraqiture në Zyrat Rajonale të AKP-së në Prishtinë e me qëllim që t’i dorëzohet kërkesa për informata shtesë dhe ky njoftim u publikua me dt.18.05.2015 në gazetën shqip, "Koha Ditore" dhe "Zëri" si dhe gazeta në gjuhën serbe, "Danas dhe "Vijesti" por paditësi, nuk ishte i paraqitur dhe se AL-ja, kërkesë e paditësit, e kishte refuzuar duke u bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L - 034 të AKP-së por edhe pse paditësi, padisë së tij, në ndërkohë, ia kishte bashkëgjitur provat gjegjëse siç janë : Vendimi i AL-së, PRN126-0208 i dt.31.03.2015, kopjen e dëftesës gjegjëse të paditësit, kopjen e Vendimeve, të DD, "Auto- Prishtina", Prishtinë për caktimin e paditësit për kryerjen e detyrave të punës, kopjen e Vendimit, Nr.442 të dt.29.06.1992 të DP, "Auto- Prishtina", Prishtinë për pagesën e tejkaluar të punës dhe regjisë, kopjen e Aktvendimit, Nr.02 – 716 të dt.29.12.1991 DP, "Auto- Prishtina", Prishtinë për sistemin e paditësit në vendin gjegjës të punës – autorfarbar, kopjen e deklaratës së dt.06.12.1977 së paditësit, kopjen e Vërtetimit mbi përvojën e punës të dt.05.12.2023 prapë se prapë, kjo kërkesë e tij është e pabazuar pas vdekjes së paditësit, trashëgimtarja e tij, e në këtë rast, F H nga Prishtina, bashkëshortja e tij, nuk ka legjitimacion aktiv që të jetë palë në procedurë dhe nuk ka të drejtë që të kërkojnë këtë kompensim sepse kërkesat e kësaj natyre juridike, lidhen me personalitetin e paditësit, T H nga Prishtina, tani i ndjerë dhe të njëjtat nuk mund të barten tek familjarët e tij, andaj pasi gjykata, që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por edhe sipas detyrës zyrtare, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpapia e paditësit, T H nga Prishtina, i përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, F H nga

Prishtina për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 14,690 € për periudhën prej dt.30.09.2003 deri me dt.01.06.2014 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Auto Prishtina" me seli në Prishtinë (në likuidim), është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet si e pa bazuar, dhe se Vendimi, PRN 126-0208 të dt.31.03.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë

Kosovare të Privatizimit (AKP), duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të jap arsyetime tjera ligjore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata, vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 34, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit, nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 153, 159, 160, 190, 197 dhe nenit 199 të Ligjit, Nr.03/L 066 për Procedurën Kontestimore (LPK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:163634, 26.01.2024

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi nga pala e pa kënaqur mund të parashtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe atë brenda afatit prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, pas ditës së pranimin të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPSGJSK).